

Raport Muaji Gusht 2023

Informacion bazë

| | |
|--|---|
| Administrimi i Fondit | Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a |
| Monedha | Euro |
| Datë Lancimi | 22 Nentor 2012 |
| Vlera fillestare e kuotës | 100 |
| Shuma fillestare minimale | 250 |
| Shuma minimale pasuese | 50 |
| Komisione dhe Tarifa | |
| Tarifë në hyrje | 0.00% |
| Tarifë në dalje | 0.00% |
| Tarifë Administrimi në vit | Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve |
| Tarifa te tjera te vazhdueshme | Referojuni prospektit te fondit |
| Komisione/tarifa të vazhdueshme | 1.48% per vitin 2022 |
| Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta | Referojuni informacionit ne deget e RBAL |

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e aseteteve te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emetuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.


Fondi eshte i pershtatshem per individet dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.

Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.48% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% ne vit te vlerës neto të aseteteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

| | |
|-------------------------------|-------------------------------|
| Risk i ulët | Risk i lartë |
| Përfitimet tipike më të ulëta | Përfitimet tipike më të larta |



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31 Gusht 2023


| | |
|---|-------------------|
| Vlero Neto e Aseteve | 31,502,174 |
| Numri I Investitoreve | 1,442 |
| Cmimi I Kuotes | 108.4496 |
| *Kthimi Vjetor nga Investimi (31.08.2022 – 31.08.2023) | 1.87% |

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Struktura e Portofolit të investimeve më 31 Gusht 2023

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur riskun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përçindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriterëve të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.



Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 31 Gusht 2023, përçindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore ka pësuar rritje në 48% të asetëve dhe 46.8% i përkasin obligacioneve të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë. Fondi ka bërë investime të reja në obligacione të korporatave me vlerësim të lartë, me kohëzgjatje afatmesme. Asetet e fondit të investuara në obligacione korporatash dhe fondet investimesh me vlerësim të lartë përbëjnë 47.6% të totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita është ulur në nivelin 5.6% e totalit të asetëve të fondit.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 31.5 milionë EUR në fund të muajit Gusht.


Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjatë muajit Gusht

Gjatë muajit Gusht cmimi i kuotes është rritur me **0.05%**, i gjashti muaj radhazi me ecuri mujore pozitive.

Tregu i obligacioneve ishte i paqëndrueshëm, me yield-et në rritje gjatë një pjese të konsiderueshme të Gushtit, pasi deklaratat e zyrtarëve të Bankës Qendrore treguan vendosmëri për të mbajtur normat e larta për më gjatë se sa pritej. Megjithatë, ditët e fundit të muajit sollën sërish rënie të yield-eve për shkak të rritjes së shpresave mbi përfundimin e ciklit shtrëngues, të paktën për SHBA-në. Si rezultat, ecuria e yield-eve të Gushtit pati një ndikim pothuajse neutral në portofolin e investimeve të fondit Invest Euro.


Kthimi neto vjetor i fondit është +1.87% më 31 Gusht 2023.

Ecuria e performancës së Fondit Raiffeisen Invest Euro



| Ne dt 31 Gusht 2023 | 1 Vit | 3 Vite | 5 Vite | 7 Vite | 10 Vite | Nga lancimi (22 Nentor 2012) |
|-------------------------------|--------|--------|--------|--------|---------|------------------------------|
| Kthimi ne % p.a per periudhen | +1.87% | -1.99% | -1.30% | -0.73% | +0.58% | 0.76% |

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitoret e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Gusht

Norma vjetore e inflacionit në SHBA u përshpejtua në 3.2% në Korrik 2023 nga 3% në Qershor, por nën parashikimet prej 3.3%. Kjo shënon një ndryshim prej trendit rënës të 12 muajve radhazi, sepse një vit më parë, inflacioni kishte filluar të binte nga kulmi prej 9.1%. Ndërkohë, inflacioni bazë, i cili përfshijon ushqimin dhe energjinë, u ul pak në 4.7% nga 4.8% në Qershor, nën pritshmëritë prej 4.8%.

Inflacioni në eurozonë rezultoi më i lartë se sa prisnin analistët për muajin Gusht, megjithëse ishte i pandryshuar nga muaji i kaluar, në nivelin 5.3%. Inflacioni bazë, një metrikë kyçe për Bankën Qendrore Evropiane, ra gjatë të njëjtës periudhë me 0.2 përqind dhe tani është në të njëjtin nivel me inflacionin total — në 5.3%.

Prodhimi i Brendshëm Bruto i SHBA u rrit me një ritëm të rishikuar prej 2.1% në tremujorin e dytë, nën vlerësimin e mëparshëm të qeverisë. Megjithatë, të dhënat ekonomike janë relativisht solide për SHBA-në, duke sugjeruar se normat më të larta të interesit kanë patur një ndikim jashtëzakonisht të vogël. Shifrat e zbutura mbi vendet e reja të punës dhe nivelin e besimit të konsumatorëve ngritën shpresat se Rezerva Federale mund të jetë afër fundit të ciklit të saj shtrëngues. Nga ana tjetër, në Jackson Hole, Powell shprehu vendosmërinë e tij për të rritur më tej normat, nëse është e përshtatshme, dhe për të mbajtur politikën në nivele kufizues derisa të ketë besim se inflacioni po lëviz drejt objektivit të Fed. Tregjet po i japin një mundësi 50% një pauze në mbledhjen e Shtatorit.

Të dhënat ekonomike nuk kanë qenë optimiste për BE-në, ndërkohë që inflacioni vazhdon të jetë i lartë. Christine Lagarde shmangu adresimin e perspektivave për mbledhjen e 14 Shtatorit në Jackson Hole dhe vetëm vërejtë se inflacioni mbetet “i pamposhtur”. Tregjet po peshojnë nëse shtrëngimi shtesë monetar është i domosdoshëm, apo një perspektivë e dobët ekonomike është mjaftueshëm e zymtë për të garantuar një pauzë.

Tregu i obligacioneve ishte i paqëndrueshëm gjatë muajit. Yield-et u rritën gjatë një pjese të konsiderueshme të Gushtit, pasi Bankat Qendrore treguan vendosmëri për t'i mbajtur normat të larta për më gjatë se sa pritej. Megjithatë, ditët e fundit të muajit sollën sërish rënie të yield-eve për shkak të rritjes së shpresave mbi përfundimin e ciklit shtrëngues, të paktën për SHBA-në. Prandaj, muaji Gusht u mbyll me yield-e në nivele pothuajse neutrale krahasuar me muajin Korrik.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.